

# AKT THEMELIMI

## PER SHOQERINE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

### "Illumina Beauty Academy" sh.p.k.

Ne baze te nenit 230/2 te ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" sot me date **04.10.2022** une i nenshkruari Z. Blerina Gula , shtetas shqiptar, lindur ne Librazhd me 28.12.1983 e me banim ne Tirane, Shqiperi, madhor dhe me zotesi per te vepruar, me Nr. ID I36228012I kam vendosur te krijoj nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar "Illumina Beauty Academy" SHPK, me permbajtje si me poshte vijon:

#### **Pjesa e pergjithshme**

Ky akt themelimi dhe Ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" rregullojne organizimin dhe funksionimin e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar "Illumina Beauty Academy" SHPK.

#### KAPITULLI I

THEMELIMI, EMERIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA

#### **Neni 1- Themelimi, Forma dhe Ortaket**

**1.1** Sot me date **04.10.2022** une i nenshkruari Z.Blerina Gula ne cilesine e ortakut te vetem te Shoqerise kam vendosur te krijoj nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, veprimtaria e se ciles do te rregullohet me ane te ketij Statuti dhe Akti te Themelimit dhe ne perputhje me Ligjin 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

**1.2** Shoqeria "Illumina Beauty Academy" SHPK krijohet si nje shoqeri me Pergjegjesi te kufizuar nga ortaku i vetem i meposhtem:

Z. Blerina Gula , shtetas shqiptar, lindur me 28.12.1983 e me banim ne Tirane, Shqiperi, madhor dhe zotesi per te vepruar, me ID Nr. I36228012I.

**1.3** Shoqeria do te funksionoje sipas legjislacionit shqiptar.

**1.4** Akti themelimit eshte ne perputhje me legjislacionin shqiptar qe ka karakter te detyrueshem ndersa ceshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuara ne to, plotesohen nga legjislacioni shqiptar.

## **Neni 2- Emertimi**

**2.1** Emertimi i Shoqerise eshte "Illumina Beauty Academy" SHPK.

## **Neni 3- Objekti i Shoqerise**

**3.1** Kurse profesionale "Beauty Center".

## **Neni -4 Selia**

**4.1** Selia e Shoqerise eshte Selite, Rruga "Bilal Sina" prane "Kopshit Zoologjik", e regjistruar ne ZVRPP me nr.pasurie 153/143-N2 ZK 3292 volumi 49 faqe 187.

**4.2** Transferimi i Shoqerise ne nje vend tjetër behet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

**4.3** Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te vendose hapjen e filialeve, degeve dhe perfaqesive te Shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise si dhe jashte saj.

## **Neni -5 Kohezgjatja e veprimtarise**

**5.1** Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise do te jete per nje periudhe te pakufizuar.

**5.2** Shoqeria mund te priset ne cdo kohe me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

## **KAPITULLI II**

**KAPITALI THEMEITAR, KONTRIBUTET, NDARJA E KUOTAVE TE KAPITALIT**

## **Neni 6- Kapitali themeltar**

6.1 Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 10.000 (dhjetemije) leke.

6.2 Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga 1 (nje) kuote, te nenshkruar me vlere nominale prej 10.000 (dhjetemije) leke .

## **Neni 7- Kontributet dhe kuotat e kapitalit**

7.1 Kontributi i kapitalit ne kapitalin e shoqerise eshte ofruar si me poshte:

Z. Blerina Gula, shtetas shqiptar, lindur me 28.12.1983 e me banim ne Tirane, Shqiperi, madhor dhe me zotesi per te vepruar, me ID nr. I36228012I ofron nje kontribut ne para te barabarte me 10.000 (dhjetemije) Leke.

7.2 Sipas kontributeve te mesiperme :

Z. Blerina Gula, i perkasin 1 (nje) kuote e barasvlershme me 10.000 (dhjetemije) leke, qe I korrespondojne 100% (njeqind perqind] te kuotave te kapitalit te shoqerise.

## **Neni 8- Rritja e kapitalit themeltar**

8.1 Kapitali themeltar mund te rritet pa kufi ne cdo moment, nje ose disa here me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve qe perfaqesojne ~ e kapitalit te shoqerise.

8.2 Ne rast rritjeje te kapitalit, kuotat e ortakeve te shoqerise do te rriten sipas shumave te percaktuara ne vendimin e asamblese se pergjithshme te ortakeve.

## **Neni 9- Zvogelimi i kapitalit themeltar**

9.1 Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin themeltar me vendimin e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve. Ne cdo rast kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen kufijte e parashikuara nga ligji .

9.2 Zvogelimi i kapitalit perballohet nga secili prej ortakeve sipas shumave te percaktuara ne vendimin e asamblese.

## **Neni 10- Transferimi I kuotave te kapitalit dhe e drejta e parablerjes**

10.1. Kuotat e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve sipas nenit 73 te ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ",

10.2 Ne rast transferimi te kuotave te kapitalit ne cdo lloj forme personave te trete, si me shperblim ashtu edhe pa shperblim, me cdo kusht, duke perfshire edhe dhurimin e kuotave, ortaket e tjere gezojne te drejten e parablerjes mbi keto kuota kapitali.

## **KAPITULLI III**

### **ASAMBLEJA, ADMINISTRATORET DHE EKSPERTI KONTABEL**

#### **Neni 11- Asambleja e ortakeve**

11.1 Organi vendimmarres i Shoqerise eshte Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve.

11.2 Cdo ortak ka te drejte te marre pjese Asamble, te paraqese mendimin e tij dhe te jape aq vota sa eshte numri i pjeseve te kapitalit qe zoteron.

11.3 Cdo ortak ka te drejte te perfaqesohet nga nje person tieter ortak, i pajisur me prokure me shkrim, me ane te se ciles mund te jape voten e tij.

11.4 Ortaku nuk mund te leshoje prokure per votim per nje pjese te kapitalit qe zoteron, neqofte se voton personalisht per pjesen e mbetur.

11.5 Asambleja mund te thirret ne cdo moment nga nje prej Administratoreve ose nga nje ose disa ortakeve qe perfaqesojne te pakten 5%( pese perqind) te kapitalit themeltar. Ne cdo rast, Asambleja thirret te pakten nje here ne vit, jo me vone se fundi i muajit te Qershorit per te diskutuar, vleresuar dhe miratuar bilancin e vitit te fundit financiar.

11.6 Asambleja duhet te thirret nepermjet njoftimit me leter rekomande me kthim pergjigje qe duhet t'u dergohet ortakeve te pakten 7(shtate) dite perpara mbledhjes se Asamblese. Thirrja duhet te mbaj informacion mbi llojin e

Asamblese, mbi ceshtjet qe do te trajtohen dhe per te cilat duhet te merret vendimi mbi vendin, oren dhe daten e thirrjes se pare dhe te dvte.

11.7 Asambleja do te quhet rregullisht e mbledhur edhe nese formalitetet e thirrjes nuk respektohen, nese ortaket qe perfaqesojne kapitalin e plote jane te pranishem apo te perfaqesuar dhe jane dakord te mbajne mbledhjen edhe formalitetet e lartpermendura nuk jane respektuar.

11.8 Cdo Asamble drejtohet nga Kryetari i emeruar ndermjet ortakeve ose personave te trete. Per pasqyrimin e vendimit Asambleja emeron nje Sekretar, qe mund te jete edhe jo ortak, ne se prania e noterit nuk eshte e nevojshme.

11.9 Asambleja mund te thirret edhe jashte selise se Shoqerise, ne Shqiperi apo jashte saj. Mbledhjet e Asamblese mund te mbahen edhe nepermjet telekonferences dhe video konferences , me kusht qe te gjitha pjesemarresit te mund te identifikohen dhe ti lejohet atyre te ndjekin diskutimin dhe te nderhyjne ne momentin e trajtimit te argumenteve; pasi te jene verifikuar keto kerkesa qe duhet te rezultojne ne procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur ne vendin ku ndodhet Kryetari ne te cilin duhet te ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.

## **Neni 12- Kuorumi dhe kompetencat e Asamblese**

12.1 Vendimet e Asamblese se Pergjithshme, te cilat merren me shumice te zakonshme, jane te vlefshme nese jane te pranishern ortake me te drejte vote qe perfaqesojne me shume se 51% te kapitalit. Ne rast mungese te ketij kuorumi ne mbledhjen e pare, Asambleja thirret ne mbledhjen e dvte me te njejtin rend dite jo me vone se 7 (shtate) dite pas mbledhjes se pare. Asambleja e Zakonshme merr vendime me shumicen e thieshte te ortakeve te pranishem te perfaqesuar.

12.2 Vendimet e Asamblese Pergjithshme, te cilat merren me shurnice te kualifikuar, jane te vlefshme ne se jane te pranishern ortaket me te drejte vote qe perfaqesojne me shurne se 71% te kapitalit. Ne rast mungese te ketij kuorumi ne mbledhjen e pare Asambleja thirret ne mbledhjen e dvte me te njejtin rend dite jo me vone se 7(shtate) dite pas mbledhjes se pare. Asambleja e Jashtezakonshrne merr vendime me shumicen e kualifikuar % te ortakeve te pranishern apo te perfaqesuar.

12.3 Asambleja e Pergjithshme merr vendime me shumice te kualifikuar % te ortakeve te pranishern per ndryshimet e statutit, rritjen apo zvogelirnin e kapitalit te shoqerise, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe shkrirjen e shoqerise dhe te gjitha rastet e tjera te parashikuara me ligj nga ky statut.

### **Neni 13- Administrimi**

13.1 Shoqeria administrohet nga 1(nje) Administrator I cili qendron ne detvre deri ne revokimin apo doreheqjen, per nje periudhe prej 5(pese)vjet me te drejte rizgjedhjeje nga Asambleja per te njejten periudhe.

13.2 Administratori/et mund te ndermarrin te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshernte shoqerise, me perjashtim te atyre qe ju rezervohen organeve te tjera te shoqerise nga ky statut apo ligji i zbatueshern.

13.3 Perfaqesimi ligjor i Shoqerise i perket Administratorit. Administratori i vetem I Shoqerise eshte Z. Blerina Gula, shtetas shqiptar, lindur me 28.12.1983 e me banim ne Tirane, Shqiperi, Blerina Gula, madhor dhe me zotesi per te vepruar, me ID nr. I36228012I .

13.4 Admmistratori/et mund te emreroje/ne perfaqesues te posacem per akte te vecanta ose per kategori aktesh .

### **Neni 14-Eksperti kontabel i autorizuar**

14.1 Ne rast se percaktohet nga ligji apo kerkohet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabel te Shoqerise mund t'i besohet nje eksperti kontabel te autorizuar.

14.2 Eksperti kontabel i autorizuar do te emerohet per 1(nje) vit ushtrimor financiar dhe do te mbaroje mandatin e tij ne daten e asamblese se mbledhur per miratimin e bilancit te vitit te kaluar ushtrimor, me te drejte rizgjedhje.

14.3 Eksperti kontabel i miratuar mund te revokohet sipas normave te legjislacionit ne fuqi.

## KAPITULLI IV

### VITI FINANCIAR ,BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE

#### **Neni 15-Viti financiar dhe bilanci vjetor**

15.1 Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te secilit vit.

15.2 Viti i pare ushtrimor fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise prane Oendres Kombetare te Regjistrimit dhe perfundon ne 31 dhjetor te atij viti.

15.3 Bilanci vjetor, inventari, relacioni i Administratorit/ve dhe eventualisht i ekspertit kontabel (nese eshte emeruar) do te miratohen nga Asambleja sipas shumices se percaktuar ne ligjin 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

15.4 Miratimi i dokumenteve qe kane te bejne me vitin ushtrimor do te behet brenda 6 muajve nga data e mbarimit te vitit ushtrimor.

#### **Neni 16- Fitimet**

16.1 Fitimet qe rezultojne nga bilanci duke zbritur 5%(peseperqind) per rezerva ligjore deri ne arritjen 10%(dhjete perqind] te kapitalit si dhe shumet e tjera qe mund te lene menjane Asambleja me vendim, u shperndahen ortakeve ne proporcion me pjeset e kapitalit themeltar te zoteruara.

16.2 Asambleja mund te vendose edhe zbritje te vecanta ne favor te rezervave te [ashtezakonshrne ose per qellrne te tjera apo edhe shtyrjen e shpemdaries se Fitimeve , plotesisht ose pjeserisht, per vitet e tjera financiare.

## KAPITULLI V

### SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMII SHOQERISE

#### **Neni 17- Prishja**

17.1 Shoqeria priset me perfundlmln e afatit te parashikuar nga Statuti, ose perpara perfundirnit ne rastet e paparashikuara nga ligji, ose me ane te nje

vendimi te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, me shumicen e kerkuar per ndryshimet ne statut.

17.2 Shoqeria nuk priset ne rast te humbjes se zotesise per te vepruar, pazotesisejuridike, vdekjes ose falimentimit te ortakeve.

## **Neni 18- Likuidimi**

18.1 Ne rast prishjeje, Shoqerla duhet te likuidohet.

18.2 Per te administruar kete procedure, Asambleja emeron nje ose me shume likuidatore, te cilet paraqesin raportet perfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivit te bilancit te Shoqertse, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohen e nevojshme per te perfunduar likuidimin.

18.3 Me perfundimin e procedures se likuidimit Asambleja do te vendose mbi bilancin financiar perfundimtar, mbi punen e kryer nga likuiduesi dhe mbi perfundimin e procesit te likuidimit.

18.4 Pas pagimit te kreditoreve dhe mbledhjes se kredive, likuidatori do t'i shperndaje te ardhurat perfundimtare te likuidimit te ortakeve, ne proporcion me kuotat e kapitalit te zoteruara prej tyre ne kapitalin themeltar.

## **Neni 19- Zgjidhja e mosmarreshjeve**

19.1 Te gjitha mosmarreshjet midis paleve qe mund te lindin ose lidhen me interpretimin dhe/ ose zbatimin e ketij Statuti dhe Akti te Themellimit si dhe ne pergjithesi cdo mosmarreshje qe mund te lind mes ortakeve (pervec mosmarreshjeve qe kane te bejne me raporte personale dhe nuk lidhen me shoqerine), ose midis disa ortakeve me shoqerine do te zgjidhen me mirekuptim midis paleve me diskutim te drejtperdrejte te te interesuarve

19.2 Nese nuk arrihet qe nje mosmarreshje te zgjidhet me mirekuptim, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane do te jete kompetente per zgjidhjen e mosmarreshjeve.



## **Neni 20- Gjuha**

20.1 Ky Statut nenshkruhet ne 2(dy) kopje ne gjuhen shqipe.

### **ORTAKU I VETEM**

**Blerina Gula**

---